REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 8736 Prot.

Lushnjë 14 / 09 / 2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: "NDËRTIMI I KOPSHTIT TË RI KASHTËBARDHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE KARBUNARE ,BASHKIA LUSHNJË" .

Të nderuar këshilltarë/ këshilltarë

Pas marrjes së vendimit për prishjen e godinës së rrënuar të Shkollës 9-Vjeçare "Kashtëbardhë", është evidentuar si nevojë emergjente ndërtimi i një godine të re për funksion kopshti, në sipërfaqen e lirë të krijuar pas prishjes së objektit ekzistues.

Ndërtimi i kopshtit në këtë sipërfaqe synon t'i përgjigjet nevojave aktuale të komunitetit ,ndërkohë që pozicionimi dhe shtrirja e godinës janë konceptuar në mënyrë të tillë që të mos cenojnë hapësirën dhe potencialin e truallit për ndërtimin e një shkolle të re në të ardhmen, në përputhje me nevojat që mund të lindin nga komuniteti.

Projekti parashikon krijimin e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve parashkollore, si dhe realizimin e hapësirave rekreative dhe të gjelbra, përfshirë sipërfaqe të gjelbëruara, lulishte dhe ambiente të përshtatura për lojë dhe qëndrimin në natyrë të fëmijëve. Gjithashtu, do të realizohen të gjitha punimet konstruktive, arkitektonike dhe inxhinierike, përfshirë mbulesën e objektit, fasadat dhe rifiniturat, dyert dhe dritaret, nyjet sanitare, rrjetet elektrike dhe hidrosanitare, sistemin e ngrohjes dhe ventilimit, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, sistemin e largimit të ujërave të shiut, si dhe sistemimin dhe rikualifikimin e ambienteve të jashtme. Ndërtimi i godinës së re të kopshtit synon krijimin e një infrastrukture të sigurt, funksionale dhe bashkëkohore, të përshtatur me nevojat e fëmijëve dhe kërkesat për zhvillimin e aktivitetit parashkollor, duke zëvendësuar funksionin e mëparshëm të godinës së shkollës.

Kjo ndërhyrje parashikohet të financohet nga shoqata"Fondacioni Mirënjohja" me vlerë 18 405 340.38

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Konc. Ark. Alban Manoku

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

Adresa: Rruga Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 222 30 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJË

Nr. 8736/1 Prot.

Lushnjë, më 14.09.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 84 DATË 14/09/2026

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT "NDËRTIMI I KOPSHTIT TË RI KASHTËBARDHË" NJËSIA ADMINISTRATIVE KARBUNARË, BASHKIA LUSHNJË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, shkronja "e", të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë, nenit 4, neni 5, pika 1.3, shkronja a, neni 12, neni 22 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar. Ju

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj investimin me objekt "ndërtimi i kopshtit të ri Kashtëbardhë", në pasurinë me nr. 51/1, ZK 2110 Njësia Administrative Karbunarë, Bashkia Lushnjë.

II. Ky projekt do të financohet nga Fondacioni "Mirënjohja", me vlerë **18 405 340.38** (tetwmbwdhjetw miljon e katërqind e pesë mijë e treqind e dyzetë pikë tridhjetë e tetë) lekë.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria Juridike Prokurime dhe Aseteve, Bashkia Lushnjë.

Drejtoria e Planifikimit

Ariola Beqo

Drejtoria e Legjislacionit

Enejd Dhamo

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com